

të mbizotroj  
савладати  
свалс

UNITED NATIONS  
United Nations Interim  
Administration Mission  
in Kosovo



NATIONS UNIES  
Mission d'Administration  
Intérimaire des Nations Unies  
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

MEMORENDUM ZYRTAR

СЛУЖБЕНИ MEMORENDUM

<b>Për/ За / To</b>	Të gjithë Deputetët e Kuvendit Све Посланике у Скупштини All Members of the Assembly	<b>DATA</b> <b>ДАТУМ</b>	5 Korrik 2002
		<b>DATE</b>	5 Јула 2002.година 5 July 2002
<b>NGA/ ОД / FROM</b>	Franck Boulin Ushtrues i detyrës së Sekretarit të Kuvendit / Вршилац дужности Секретара Скупштине / Acting Secretary to the Assembly	<i>per Claresa Sartees</i>	
<b>SUBJEKTI</b> <b>ПРЕДМЕТ</b> <b>SUBJECT</b>	Mbledhja e Kuvendit / Заседање Скупштине / Meeting of the Assembly		

Mbledhja e ardhshme e Kuvendit do të mbahet:

**Të enjten më 11 Korrik 2002 në orën 10:00**  
**Në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.**

Ftohën të gjithë Deputetët e Kuvendit të marrin pjesë.

Rendi i ditës është i bashkëngjitur.

Следећа седница че бити одржана:

**Четвртак 11 Јула 2002 у 10.00 часова**  
**У Скупштинској Сали у згради Скупштине Косова**

Сви Посланици се позивају да учествују.

Дневни ред је у прилогу.

The next meeting of the Assembly will take place on:

**Thursday 11 July 2002 at 10.00 am**  
**Assembly Hall, Assembly Building, Pristina**

All members of the Assembly are invited to attend.

The agenda for the meeting is attached.



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**  
**RENDI I DITËS**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Prezentimi dhe leximi i parë i Projektligjit Nr. 2002/2 për arsimin e lartë në Kosovë
3. Prezentimi dhe leximi i parë i Projektligjit Nr. 2002/3 për arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë
4. Rezimeja e debatit mbi mocionet e Qeverisë dhe Amandamentet e propozuara në seancën e 04korrikut 2002 për komunitetet dhe anëtarë e tyre në lidhje me kushtet e kthimit të refugjatëve dhe të zhvendosurve
5. Parashtrimi i pyetjeve

---

**ДНЕВНИ РЕД**

1. Усвајање записника са прошле седнице
2. Представљање и читање Нацрта закона бр.2002/2 о високом образовању на Косову
3. Представљање и читање Нацрта закона бр.2002/3 о основном и средњем образовању на Косову
4. Резиме расправе о предлогу Владе и Амандманима поднетим на пленарном заседању од 04јула 2002 године о мањинским заједницама и њиховим члановима у вези са условима за повратак избеглица и расељених лица
5. Постављање питања

---

**AGENDA**

1. Approval of minutes
2. Presentation and First Reading of Draft Law No. 2002/2 on *Higher Education in Kosovo*
3. Presentation and First Reading of Draft Law No. 2002/3 on *Primary and Secondary Education in Kosovo*
4. Resumption of debate on draft motion from the Government, and on amendments proposed in the plenary on 4 July 2002, on communities and their members and on the conditions for the return of IDPs and refugees
5. Questions

X

## KUVENDI I KOSOVËS MBAJTUR MË 11.7.2002

### KRYETARI NEXHAT DACI

Pika e parë.

Pika e parë, aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

E dyta, shqyrtimi i parë i projektligjit për arsimin e lartë në Kosovë,

Tre, shqyrtimi i parë i projektligjit për arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë dhe

Katër, rezimea e debatit mbi mocionet e Qeverisë dhe amendamentet e propozuara në seancën e 4 korrikut për komunitete dhe anëtarët e tyre, prandaj pyes a ka dikush ndonjë pyetje, a aprovohet rendi i ditës.

Vazhdimisht 7 muaj i kemi të njejtat probleme, të komunikimit përkthimit, gjuhësor në komunikimin e shkruar, dokumentet e shkruara,

### XHAVIT HALITI, PDK

Mendoj, që procesverbalin nuk ka të bëjë vetëm me çështjet e drejtëshkrimit, të lekturimit, ose ata që i pëpilojnë procesverbalet kalojnë çështje shumë të rëndësishme që janë diskutuar dhe propozuar në këtë Parlament dhe në veçanti do të jepja vërejtje për propozimin tim rreth procedurës që është ndjekur në mbledhjen e kaluar. Unë nuk jam një diskutues i radhës qysh e ka nxjerrë këtu, ai që e ka shkruar për çef të vetin këtë procesverbal, ose ai që se ka dëgjuar këtë procesverbal, ose ai që s'është interesuar që zëri i deputetëve në të procedohet në mënyrë të rregullt njësoj për të gjithë. Unë kam kërkuar decidivisht që propozimi i Qeverisë për ligjin të hedhet në votim dhe pjesa shtesë e propozuar të propozohet si ligj i veçantë, për fatin një shtesë e tillë në ligjin e propozuar do t'i detyrojë mekanizmat që ta kthejnë pas në rishqyrtim nëpër komisionet dhe mendoj se nuk do ta konsiderojë si ligj të miratuar. Të njejtën gjë e ka bërë edhe Kryesia, Kryesuesi i seancës ka hedhur në votim propozimin e dytë që mendoj sipas rregullit procedural nuk ka qenë e rregulltë.